**VENDIM**
**Nr. 55, datë 18.4.2017**

# MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALB ENERGY MARKET" SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d" të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "e"; 5, pika 1 germa "e"; 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave ne sektorin e energjisë Elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19 pika 1 germa "a" e Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr.96 datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.4.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "ALB ENERGY MARKET" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Alb Energy Market" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 germat "a", "b", "c"), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat "a", "b", "c", "d", "e"), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat "a", "b" "c", "d"), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat "a", "b", "c", "d"), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Alb Energy Market" sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**